



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 220/1 Prot.

Tiranë, më 20 . 02 . 2024

V E N D I M

Nr. 50 , Datë 20 . 02 . 2024

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr.16 Regj., datë 07.02.2024, paraqitur nga z. A. Gj, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Veprave Penale Shënkoll, Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti ankues, në kronologji kohore të rrethanave e fakteve të parashtruara prej tij, evidentohet si më poshtë vijon:

Z. A. Gj ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (në vijim referuar me akronimin DPB), konkretisht pranë Institucionit të Ekzekutimit të Veprave Penale Shënkoll-Lezhë (në vijim referuar me akronimin I EVP Lezhë), për periudhën kohore nga data 23.03.2006 deri më datë 01.05.2021. Nga data 01.05.2021 është transferuar në I EVP Fushë-Krujë, deri më datë 23.07.2023, kur është liruar nga detyra, me kërkesën e tij. Referuar Librezës së Punës¹, ai ka përfituar pagesën kalimtare nga data 23.07.2021 deri më datë 23.07.2023.

¹ Dokumenti Librezë Pune me nr. regj. them.207, datë 30.03.2016.

Pas përfundimit të periudhës dy vjeçare gjatë së cilës ka përfituar pagesën kalimtare, nëpërmjet kërkesës me nr. 6594 regj., datë 03.08.2023, ankuesi ka aplikuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lezhë (në vijim referuar me akronimin DRSSH Lezhë), për pension të parakohshëm të ushtarakut, bazuar në nenin 13, 14, e vijues të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 *“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Nëpërmjet shkresës me nr. 6594/1 prot., datë 02.09.2023, të DRSSH Lezhë, subjektit ankues i është refuzuar lidhja e pensionit suplementar të pleqërisë si ish- ushtarak, me arsyetimin se, bazuar në shkresën e dërguar nga DPB, ai nuk plotëson 15 vite punë si ish-punonjës i Policisë së Burgjeve.

Me shkresën me nr. 7629 prot., datë 11.09.2023, ankuesi ka kundërshtuar pranë Komisionit Rajonal të Ankimit, pranë DRSSH Lezhë², përgjigjen e DRSSH Lezhë.

Me Vendimin nr. 103, datë 19.09.2023, Komisioni Rajonal i Ankimit/DRSSH Lezhë, (komunikuar ankuesit nëpërmjet shkresës me nr. 4215 prot., datë 27.09.2023), ka vendosur: *“Mosshqyrtimin e ankesës së z. A. Gj, për arsye se nuk ka kompetencë ligjore e lëndore për shqyrtimin e rasteve ankimore për përfitime të caktuara në zbatim të ligjit nr. 10142/2009.”*

Ankuesi pretendon se, nga verifikimi i Libresës së Punës dhe verifikimi pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, ai nuk ka patur shkëputje nga puna, që nga data e fillimit punë me datë 23.05.2006, deri me datë 23.07.2021, kur është larguar me kërkesën e tij, si dhe për periudhën nga data 23.07.2021 deri me datë 23.07.2023 ka përfituar pagesën kalimtare.

Në pamundësi për të verifikuar vjetërsinë e tij në punë pranë I EVP-ve ku ka punuar, nëse ka patur shkëputje nga puna, nëse i është paguar kontributi suplementar, nëse janë pasqyruar në mënyrë të saktë vitet e tij të punës, etj, nëpërmjet shkresës me nr. 2243 prot., datë 17.10.2023, ankuesi i është drejtuar DPB-së, për verifikimin dhe konfirmimin e viteve të punës së tij, me qëllim përfitimin e pensionit të pjesshëm të ushtarakut.

Nëpërmjet shkresës me nr. 2243/1 prot., datë 15.11.2023, DPB, në përgjigje të kërkesës së z. Gj, ndër të tjera, shprehet se:

- *“IEVP Lezhë, ka mbajtur detyrimin suplementar me daljen e aktit normativ e në vijim, dhe nuk e ka implementuar për gjithë periudhën nga data 01.07.2009-31.12.2010, duke e ndarë në 6 mujorë, siç kanë vepruar institucionet e tjera.*
- *Gjithashtu ju informojmë se, ky detyrim nuk është mbajtur nga paga e z. Gj.*

² Akronim për Drejtorinë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Lezhë.

- *Derdhja e kontributeve suplementare ka filluar me datë 01.10.2010. Për periudhën 01.07.2009-30.09.2010, nuk janë mbajtur detyrimet e kontributit suplementar që mbahen nga paga e punëmarrësit, në rastin konkret të z. Gj.”*

Ankuesi nëpërmjet shkresës me nr. 337/1 prot., datë 13.12.2023, i është drejtuar sërish DPB-së dhe IEVP Lezhë, në të cilën përsërit kërkimet e tij, dhe ndër të tjera, parashtrohet se: “...për shkak të mungesës së korrektësisë së administratës së burgut ku kam punuar, në lidhje me mosderdhjen e kontributeve suplementare për periudhën 01.07.2009-30.09.2010, të cilat rezultojnë se nuk janë mbajtur nga paga ime, kërkoj nga ana juaj nxjerrjen e një urdhri me qëllim pagimin e kontributit suplementar për periudhën në fjalë, pasi në këtë periudhë ka qenë në fuqi ligji dhe urdhri për pagesat dhe përfitimin për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakut.

Vërtet nuk jam më punonjës i Policisë së Burgjeve, por këtë të drejtë e kam fituar me ligjin e veçantë, dhe nuk mund të privohem nga e drejta e përfitimit të pensionit të pjesshëm sipas statusit përkatës, pasi mospagesa e kontributit suplementar dhe mosmbajtja e saj nga paga, nuk është për fajin tim. Nuk mund të privohem nga e drejta ime ligjore, për shkak të mosveprimit të administratës së burgut, dhe sa më sipër kërkoj nxjerrjen e një urdhri me qëllim të më jepet mundësia për pagimin e kontributit suplementar për periudhën 01.07.2009-30.09.2010, pagesë të cilën jam i gatshëm ta kryej në çdo moment.”

Me shkresën me nr. 15136 prot., datë 22.12.2023, DPB, i ka kthyer ankuesit të njëjtën përgjigje me atë të datës 13.12.2023 (sipërcituar).

Në parashttrimet e tij pranë KMD-s, ankuesi citon se: “Për shkak të moskorrektesës së administratës së burgut, jam diskriminuar nëpërmjet mosderdhjes së kontributeve suplementare për periudhën 01.07.2009-30.09.2010, nga ana e palës ku kam punuar, duke më sjellë një dëm shumë të madh dhe mosnjohjen e vjetërsisë në punë me statusin e ushtarakut, duke më mohuar të drejtën e përfitimit të pensionit të pjesshëm.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e ish-punëdhënësit si dhe të merren masa për pagesën e pensionit suplementar të tij, për periudhën 01.07.2009-30.09.2010.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë, të padrejtë e të pafavorshëm të tij nga ana e DPB-së dhe IEVP Lezhë, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi i cili pretendon se është diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrijë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka

si bazë një apo më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, është “çdo shkak tjetër”.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkak” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë.

Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁵ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë (megjithëse i është kërkuar shprehimisht, nga specialistja e Drejtorisë së Pritjes së Ankesave) se cila ishte karakteristika apo cilësia e tij individuale, e mbrojtur, sipas përcaktimeve të LMD-së.

Në shpjegim të shkakut të pretenduar të diskriminimit, sigluar “çdo shkak tjetër”, ankuesi ka shpjeguar se: *“Diskriminimi im nga ish-punëdhënësi konsiston në pabarazinë time krahasuar me një pjesë të punonjësve të tjerë që e kanë përfituar kontributin suplementar, për periudhën nga data 01.07.2009-30.09.2010, duke më trajtuar në mënyrë të diferencuar e të pabarabartë.”*

Shpjegimi i ankuesit se ai është trajtuar ndryshe nga punonjësit e tjerë/ish-kolegë të tij, ndodhur në kushte të njëjta a të ngjashme, shërben për evidentimin e trajtimit të tij të diferencuar apo të pabarabartë, nga ana e DPB apo IEVP Lezhë, por nuk shërben për provueshmërinë apo dokumentimin e shkakut, mbi të cilin supozohet se ka ndodhur ky trajtim, në kuptim të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, *për shkak të cilësisë së veçantë a të dallueshme të ankuesit/shkakut të mbrojtur*, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

⁵ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mos ekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtrori e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi fillimisht duhet të plotësojë kërkesën minimale, lidhur me provueshmërinë e shkakut të mbrojtur.

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e DPB-së dhe IEVP Lezhë.

Komisioneri evidenton faktin se, të gjitha pretendimet e ankuesit që burojnë nga veprimet a mosveprimet e DPB-së dhe IEVP Lezhë, janë pretendime që lidhen me paligjshmërinë e tyre. Në mungesë të lidhjes me shkakun e pretenduar ato mbeten thjesht në kuadër të paligjshmërisë së tyre.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁶”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Komisioneri vëren gjithashtu se, në thelb, pala ankuese ka ngritur pretendime lidhur me dy momente: së pari për përlllogaritje të gabuar të vjetërsisë në punë dhe së dyti, për mospagesën e kontributit suplementar, për periudhën nga data 01.07.2009-30.09.2010, nga ana e DPB-së dhe IEVP Lezhë.

Pasi ka ezauruar shkallët e ankimit administrativ pranë strukturave përkatëse të DPB-së, IEVP Lezhë, DRSSH Lezhë dhe Komisionit Rajonal të Ankimit/ DRISSH Lezhë, ankuesi përsëri nuk ka gjetur një zgjidhje të favorshme në lidhje me pretendimin e tij.

⁶ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, etj.

Në bazë të nenit 86⁷, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet:

“1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;

2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (DPISSH);

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar...”

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, Komisioneri i rekomandon subjektin ankues, që, për dy problematikat e tij, të shterojë fillimisht rekursin administrativ, sipas parashikimeve të mësipërme ligjore, pranë Komisionit të Ankimit/DPISSH, dhe në rast të mosdakordësisë me vendimmarrjen e këtij të fundit, mund t’i drejtohet Gjykatës, për të adresuar pretendimin e tij për: përlllogaritjen e vjetërsisë në punë dhe mospagesës së kontributeve suplementare për periudhën 01.07.2009-30.09.2010, si institucioni përgjegjës për të marrë në shqyrtim pretendime të kësaj natyre.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës me nr. 16 Regj., datë 07.02.2024, të paraqitur nga shtetasi A. Gj, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

⁷ Ankimimi

KOMISIONERI

Robert GAJDA